

RELACION SHPJEGUES
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR SIGURIMIN E
VAZHdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve
ELEKTRONIKE NË SITUATA TË JASHTËZAKONSHME”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Projektvendimi “Për miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme”, vjen si propozim i Ministrisë për Infrastruktura dhe Energji, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 74 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektvendim ka për qëllim të miratojë masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme në përputhje me Ligjin Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti synon të plotësojë kuadrin nënligjor të nevojshëm për zbatimin e Ligjit Nr. 54/2024, si dhe të përafrohet pjesërisht me praktikën dhe parimet e Bashkimit Evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË
AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2025. Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/172 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në pikën 5 të nenit 174, parashikon që masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, me propozimin e ministrit, në bashkëpunim me strukturat e tjera të caktuara me ligj për trajtimin e situatave të jashtëzakonshme dhe me AKEP-in, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me anë të këtij projektvendimi “Për miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme”, synohet të përcaktohen masat që sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të marrin dhe plotësojnë me qëllim sigurimin e vazhdimësisë, integritetit dhe mbështetjes së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, në funksion të përballimit të situatave të jashtëzakonshme.

Projektvendimi përbën një hap të rëndësishëm drejt plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator për të përmirësuar masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, në përputhje me praktikën

ndërkombëtare dhe kërkesat në kuadër të rritjes së qëndrueshmërisë dhe sigurisë për komunikimet elektronike civile sipas rekomandimeve të NATO-s, për qëndrueshmërinë e sistemeve të komunikimit civil (BLR 6).

Miratimi i këtij akti nënligjor plotëson kuadrin nënligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” do të zbatohet për të gjithë sipërmarrësit e autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin dhe operimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, dhe autoritetet dhe strukturat shtetërore që funksionojnë apo ngrihen në raste të situatave të jashtëzakonshme.

Ky projektvendim ka rëndësi të veçantë pasi përcakton funksionimin e rrjeteve kritike të komunikimeve elektronike gjatë situatave të jashtëzakonshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 174 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVË)

Projektakti nuk bën përafrim të ndonjë *acquis communautaire* të veçantë, por është hartuar në mbështetje të pikës 5, të nenit 174 të ligjit nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti është në harmoni me kërkesat nenit 108 të Direktivës 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike që është transpozuar me ligjin nr. 54/2024.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti miraton masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, në zbatim të pikës 5, të nenit 174, të Ligjit Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektakti përmban dy nene, ku Neni 1, parashikon miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme”, siç është përcaktuar në dokumentin bashkëngjitur projektvendimit. Neni 2, ngarkon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për zbatimin e këtij vendimi.

Masat specifike për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, janë të përshkruar në dokumentin bashkëlidhur projektaktit dhe përbëhet nga 18 nene dhe 3 anekse si më poshtë:

Në nenin 1, përcaktohet që dokumenti ka për qëllim përcaktimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, me qëllim

përballimin e situatave të jashtëzakonshme duke minimizuar ndikimin e situatave të jashtëzakonshme në marrjen e shërbimeve të komunikimeve nga përdoruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe siguruar rikuperimin e shpejtë dhe të sigurt të funksioneve kritike të komunikimeve pas një ndërprerjeje të mundshme dhe siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme. Ky vendim ka për qëllim sigurimin e bashkërendimit të masave dhe bashkëpunimit për përballimin e situatave të jashtëzakonshme në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 2, përcaktohet fusha e zbatimit ku zbatohet ky vendim, për të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike

Në nenin 3, përcaktohen përkufizimet për termat e përdorura në këtë dokument. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për qëllime të këtij dokumenti, përcaktohet dhe disa disa tema si “Situatë e jashtëzakonshme”, “Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile (KNEC)”, “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)”.

Në nenin 4, përcaktohen detyrimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, në zbatim të parashikimeve të nenit 174, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike hartojnë dhe paraqesin në AKEP planin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve, sipas përcaktimeve në këtë vendim. Në situatat e jashtëzakonshme sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bashkëpunojnë me Ministrinë përgjegjësedhe institucionet dhe strukturat e ngritura në rastet e emergjencave civile. Në rastin e sulmeve kibernetike, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bashkëpunojnë me AKEP dhe AKSK sipas parashikimeve ligjore për sigurinë kibernetike

Në nenin 5, përcaktohet plani i masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve në kompanitë e telekomunikacioneve/komunikimeve elektronike dhe mirëfunksionimin e infrastrukturës së tyre në rastet e jashtëzakonshme që hartohet nga sipërmarrësi i komunikimeve elektronike përmban minimalisht parashikimet në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Në nenin 6, përcaktohen masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, duke përfshirë masat parandaluese, masat gjatë situatës së jashtëzakonshme, masat e rikuperimit. Lista e masave dhe kërkesat për dokumentimin e tyre jepen në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Në nenin 7 përcaktohen masat parandaluese që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike hartojnë dhe të mirëmbajnë planet e vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit pas fatkeqësisë. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të identifikojnë dhe raportojnë pranë AKEP asetet dhe burimet kritike të rrjetit si dhe pajisjet e lëvizshme që disponojnë me sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimit në raste të jashtëzakonshme brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Në nenin 8, përcaktohen masat e reagimit gjatë emergjencës. sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, aktivizojnë menjëherë ekipet e brendshme të menaxhimit të krizës, situatat e emergjencës dhe njoftojne pa vonesë AKEP për çdo ndërprerje të shërbimeve. Sipërmarrësit duhet të aktivizojnë kanale prioritare për komunikimin e institucioneve shtetërore dhe sipas rastit vendosin në operim pajisjet lëvizëse të rrjetit për mbulimin me shërbim. Aktivizojnë burimet alternative të energjisë për qendrat e të dhënave, stacionet dhe antenat transmetuese. Sipërmarrësit raportojnë çdo 4 orë pranë ministrisë përgjegjëse dhe AKEP-it

Në nenin 9, përcaktohen masat e rikuperimit pas emergjencës. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bëjnë vlerësimin dhe raportojnë në AKEP për dëmet brenda 48 orëve pas ngjarjes. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të rikthejnë funksionalitetin e rrjetit sipas

planit të rikuperimit të prioritetizuar, si dhe duhet të kryejnë një analizë pas ngjarjes me AKEP dhe institucionet e sigurisë. Sipërmarrësit duhet të përditësojnë planet BCP/DRP dhe të raportojnë tek AKEP dhe të ndërtojnë një manual praktik për përmirësim të kapaciteteve reaguese në të ardhmen

Në nenin 10, përcaktohen masat për sigurinë në rastet e sulmeve kibernetike. Pa anashkaluar zbatimin e masave sipas parashikimeve në nenin 20 të ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe në nenin 54 të ligjit Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën E Shqipërisë”, për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, me qëllim përballim e situatave në rastet e sulmeve kibernetike sipërmarrësit e komunikimeve elektronike marrin masa për sigurinë për infrastrukturën e komunikimeve elektronike. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike rishikojnë periodikisht politikat e brendshme të sigurisë, planet e vazhdimësisë së biznesit dhe planet e reagimit ndaj incidenteve, si dhe kryejnë rregullisht trajnimin e stafit për sigurinë kibernetike. Masat janë përcaktuar në aktesin 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

Në nenin 11, përcaktohet bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet e jashtëzakonshme dhe sipas nevojës, bazuar në Konventën Tampere dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ku Shqipëria është palë, ministria përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe AKEP, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse mund të kërkojnë ndihmë nga partneret ndërkombëtare, vendet pjesëmarrëse në Konventën Tampere, për sigurimin e pajisjeve të komunikimit të lëvizshme, përfshirë mbulimin me komunikime satelitore me qëllim sigurimin e shërbimeve të telekomunikacionit sipas përcaktimeve në Konventën Tampere.

Në nenin 12, parashikohen autorizimet e përkohshme për rastet e emergjencave. Me qëllim përballimin e situatave të emergjencave, AKEP sipas parashikimeve në ligjin për komunikimet elektronike dhe Planin Kombëtar të Frekuencave, ka të drejtë të japë autorizime të përkohshme për përdorimin e frekuencave rezervë për rastet e emergjencave me qëllim sigurimin e komunikimeve. Operatorët që veprojnë në fushën e ndihmës ndërkombëtare në rastin e marrjes së ndihmës përmes Konventës Tampere parashikuar në nenin 11, mund të pajisen me autorizim të përkohshëm për përdorimin e pajisjeve dhe frekuencave, sipas një procedure të përshtetshme. Në nenin 13, parashikohet koordinimi operacional dhe pika kombëtare e kontaktit në rastin e situatave të jashtëzakonshme, me qëllim koordinimin e veprimeve për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Pranë ministrisë përgjegjëse krijohet njësi e koordinimit që bashkëpunon me AKEP dhe autoritetet përgjegjëse për emergjencat me qëllim koordinimin e veprimeve për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimit.

Ministria cakton një pikë kombëtare kontakti për të koordinuar me ITU, autoritetet përgjegjëse për emergjencat dhe partnerët ndërkombëtarë për të kërkuar ndihmë sipas nenit 11, në zbatim të Konventës Tampere.

Në nenin 14, parashikohet krijimi dhe mbajtja e një regjistri për operatorët dhe shërbimet e autorizuar. AKEP mbi bazën e informacioneve të sipërmarrësve dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike krijon një regjistër të sipërmarrësve që zotërojnë pajisje të lëvizshme telekomunikacioni që mund të përdoren për rastet e emergjencave.

Në nenin 15, parashikohet që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të organizojnë të paktën një herë në vit testime ose simulime të kapaciteteve të telekomunikacionit në raste emergjente. Testimet dhe auditimet duhet të jenë të dokumentuara. Testimet dhe auditimet kryhen dhe me kërkesë e prezencë të përfaqësuesve të AKEP dhe/ose të Ministrisë/autoriteteve përgjegjëse.

Në nenin 16, parashikohet që veprimtaritë sipas këtij vendimi kryhen në përputhje me ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe kufizohen vetëm në masat e domosdoshme, të nevojshme dhe proporcionale për arritjen e qëllimeve të këtij vendimi.

Në nenin 17, parashikohen zbatimi i masave administrative në përputhje me parashikimet e ligjit nr.54/2024, në rast mosrespektimi të kërkesave të këtij vendimi për hartimin e planit të masave për vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimit në raste të jashtëzakonshme. AKEP mund të kërkojë pezullimin e përkohshëm të aktivitetit, revokimin e autorizimeve përkatëse. Në nenin 18 përcaktohet hyrja në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Aneksi 1 përcakton një model orientues për sipërmarrësit për Planin e Masave në ndihmë të sipërmarresve të komunikimeve elektornike. Aneksi 2, detajon masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve para, gjatë dhe mbas situatave të jashtëzakonshme dhe dokumentimi i masave. Aneksi 3, përcakton masat për vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve në rastin e sulmeve kibernetike.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare AKEP.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKEP, bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në praktikat e vendeve të BE.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim përmes e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes.

Per hartimin e projekt aktit është bere takim koordinues me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Ministrinë e Mbrojtjes, Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC).

Projekt akti do të dërgohet për mendim me shkresë pranë AKEP, AKMC dhe AKSK si dhe do të konsultohet përmes faqes së MIE me palët e interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku